



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



ZL.Anr.381/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për anëtar të Komunës së Prishtinës, Ngadhnjim Makolli, paraqitur për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e parashtruar nga kandidati për anëtar të Komunës së Prishtinës, Ngadhnjim Makolli, me shenjën ZL.A.nr.381/2017 e datë 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga kandidati për anëtar të Komunës së Prishtinës, Ngadhnjim Makolli, me të cilën ka pretenduar se në shkollën fillore “Shkëndija” në Hajvali, e kanë votuar rrethi i ngusht familjar, ku të paktën është dashur të jenë 70 vota të vlefshme. Ndërsa, nga raporti i vëzhguesve rezulton që ka vetëm 9 vota. Me këtë rast ka kërkuar që bëhet verifikimi për këtë gabim teknik.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesë sepse, pretendimet ankimore që ndërlidhen me rezultatin e votimit duhet të parashtrihen me rastin e publikimit të shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankueses Ngadhnjim Makolli, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL. Anr.381/2017 më datën 24.10.2017.



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*